



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË

Nr. 7457 Prot

Tiranë, më 30/09/2020

V E N D I M

“SHPLLJEN E SHITJES NË ANKAND TË
PASURISË SË LUAJTSHME
ANKANDI I II”

Unë, Laureta Kusi permbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.521, dt 30.04.2007 të Gjykatës të Shkallës së Parë Tiranë.

KONSTATOVA:

Së është depozituar pranë Zyrës Përmbarimore, dokumentacioni i paraqitur nga Cen Doci dhe konkretisht:

1.Kërkesa e kreditorit për venien ne ekzekutim te Urdherit te Ekzekutimit Nr.521, dt 30.04.2007 të Gjykatës të Shkallës së Parë Tiranë 2. Titullin ekzekutiv Nr.521, dt 30.04.2007 të Gjykatës të Shkallës së Parë Tiranë me pale dhe objekt:

-Kreditor: Cen Doci

-Debitor : Abdyl Tusha

-Objekti: Kthim shume

Në kushtet kur në zbatimin e K.Pr.Civile ekzekutimin e titullit ekzekutiv është vendosur masa e sekuestros mbi pasuritë objekt ekzekutimi në favor të kreditorit si garanci për kthimin e shumës dhe konkretisht mbi pasurinë e luajtshme : Automejtit Targa TR 1017 R OPEL ZAFIRA Nr.Shasie WOLOTGF7532156104

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 567, 568, 569 e 570 të Kodit të Procedurës Civile, une përmbaruese gjyqësore Laureta Kusi

V E N D O S A:

1. Shpalljen e shitjes në ankand të pasurive **Automejtit Targa TR 1017 R OPEL ZAFIRA në vlerën 67 200 lekë.**

2. Shitja e pasurisë në ankand do të bëhet ditën e **Hënë**, me datë **26.10.2020**, ora **16.00**, në Zyrën e Përmbarimit Tiranë.

3. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë/pasurive në ankand, është i detyruar të paraqitet personalisht dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesi të tij/saj me prokurë, si dhe **të dorëzojë (brenda në zarf të mbyllur) në zyrën e përmbaruesit gjyqësor deri në orën 16:00, këto dokumenta:**

a) kërkesën e tij/saj për pjesëmarrje në ankand;

b) faturën bankare të 10% të garancisë për pjesëmarrje në ankand (në origjinal);

c) dokumentin e identifikimit (Kartë identiteti ose Pasaportë). Në rast se ofertuesi është person juridik, përveç dokumenteve që paraqet çdo person fizik, përfaqësuesi ligjor duhet të paraqesë statusin, aktin e themelimit të personit juridik, një kopje të ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të certifikatës së regjistrimit dhe/ose dokumente të tjera që parashikon ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

4. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, në **e Hënë**, me datë **26.10.2020**, është i detyruar të depozitojë si garanci pranë Bankës “Credins”, Tiranë në Nr. Llog 818181 së Zyrës së Përmbartimit Tiranë një shumë të hollash të barabartë me 10 % të çmimit të pasurisë/pasurive të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

5. Debitori dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor, përmbartuesi gjyqësor, si edhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand. Kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.

7. Ky vendim hartohet në **4(Katër)** kopje. Një kopje administrohet në dosjen përmbartimore **1(një)** kopje afishohet në ambientet e Zyrës e Përmbartimit Tirane **1(një)** kopje afishohet në vendin ku ndodhen pasuritë e luajtshme; **1(një)** kopje i njoftohet debitorit; **1(një)** kopje i njoftohet kreditorit;

PËRMBARUESE GJYQËSORE

Laureta KUSI

Adresa: Sheshi “Mustafa Qemal Ataturk”, Tiranë

Tel: 0696333334